VENDIM
Nr.283, datë 28.4.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN ME KONCESION TË OBJEKTIT "SHËRBIMI I LAVANDERISË DHE I PASTRIMIT TË BRENDSHËM NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA", TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK-GJINEKOLOGJIK NR.1 E NR.2, TIRANË, DHE NË SPITALIN UNIVERSITAR TË SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 11, e 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për dhënien me koncesion, si propozim i kërkuar, të objektit "Shërbimi i lavanderisë dhe i pastrimit të brendshëm në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik nr.1 e nr.2, Tiranë dhe Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive, Tiranë".
2. Koncesioni të jetë i formës "BOT" (ndërtim-shfrytëzim-transferim), për një periudhë 5-vjeçare.
3. Ministria e Shëndetësisë është organi shtetëror i autorizuar për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion.
4. Organi shtetëror i autorizuar të ngrejë grupin e punës, për shqyrtimin e ofertave të paraqitura, sipas kritereve të mëposhtme të vlerësimit:
- Çmimi për njësi i shërbimit, jo më pak se 50 pikë;
- Vlera e investimit, 20 pikë;
- Cilësia e investitorit dhe përvoja në këtë veprimtari, 20 pikë;
- Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit, 10 pikë.
5. Procedurat e shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave të përfundojnë brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano